



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROŠEVAC

188  
Lona

27-07-2018

REPublika e Kosovës  
REPublika e Kosovës - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:014078

Datë: 21.06.2018

Numri i dokumentit: 00066726

P.nr.3069/17

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.939-5/17 të dt. 05.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të dëmtuarit [REDACTED] si dhe të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED], me datë 06.06.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 15.06.2018 përpiloi me shkrim këtë:

## AKT GJYKIM

### Të akuzuarit:

1. [REDACTED] i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED], nëna [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj rr. [REDACTED], ka të kryer shkollën mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR], nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në [REDAKTUAR], fshati [REDAKTUAR] ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANË FAJTOR

### 1. Të akuzuarin [REDAKTUAR]

Në muajin korrik të vitit 2016, rreth orës 19:00, në fshatin Rakaj komuna Ferizaj, saktësisht nga garazhi i të dëmtuarit [REDAKTUAR], i pandehuri me qëllim të përvetësimit e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit të i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, ka marr një kuti me ngjyrë të zezë të mbushura me çelësa, kaçavida dhe dana pune, një kabëll vazhdues me gjatësi rreth 50 metra, një garniturë me çelësa gidore në vlerë prej 200 €, dhe i ka shitur te i pandehuri [REDAKTUAR] për shumën prej 20€,-

**me të cilën kreu veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 nënpar. 1.1 të KPRK-së.**

### 2. Të akuzuarin [REDAKTUAR]

I pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror për vete apo dikë tjetër në mënyrë të kundërligjshme kishte pranuar mallin e vjedhur nga i pandehuri [REDAKTUAR] dhe atë një kuti me ngjyrë të zezë të mbushur me çelësa, kaçavida dhe dana pune, një garniturë me çelësa gidore ku ja kishte paguar shumën në vlerë prej 20 Euro, për të cilën e ka ditur se të njëjtat janë përfituar me anë të kryerjes së veprës penale ku janë konfiskuar nga ana e policisë.

**me të cilën kreu veprën penale blerja, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KPRK-së.**



Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të sipër cekura dhe neneve 2, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 49, 50, 51, 73, 74 dhe 81 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPR-së, i

## GJYKON

1. Të pandehurit: [REDAKTUAR]

- ME DENIM ME GJOBË në lartësi prej 300€ /treqind euro/ të cilën dënim është i obliguar te paguaj ne afat pre 30 ditëve pasi qe aktgjykimi të merrë formën e prerë nën kërcënim te ekzekutimit me dhunë.

dhe

- DENIM ME BURG në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1/një/ viti nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale.
- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 €, do të vuajnë 1 /një/ ditë burgim.
- I dëmtuari: [REDAKTUAR] Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

2. Të pandehurit: [REDAKTUAR]

- ME DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200€ /dyqind euro/ të cilën dënim është i obliguar te paguaj ne afat pre 30 ditëve pasi qe aktgjykimi të merrë formën e prerë nën kërcënim te ekzekutimit me dhunë.



- Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 €, do të vuajnë 1 /një/ ditë burgim.
- I dëmtuari: [REDAKTUAR] Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.
- Obligohen dy të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 30€ /tridhjetë euro/, në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohen të akuzuarit që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë në mënyrë solidare shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzat të evidentuar PP/II.nr.939-5/17 të dt. 05.12.2017, ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] për veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së dhe [REDAKTUAR] për veprën penale penale blerja, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 06.06.2018, në të cilën shqyrtim fillestar dy të akuzuarit e sipër cekur janë deklaruar se: [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon akuza sipas të gjitha



*pikave të saj, është i vetëdijshëm për pasojat e fajësisë që mund të vijnë nga pranimi, i vjen keq për këtë veprë penale dhe pendohet thellë, i kërkon falje publike të dëmtuarit dhe gjykatës, premtion që më nuk do të ndodhë as një veprë tjetër penale, nga ky rast ai ka ra ndesh me ligjin, gjatë matjes së dënimit e lut gjykatën të i shqiptoj një dënim më të butë.*

I akuzuari [REDAKTUAR] lidhur me pranimin e fajësisë deklaron se: *e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon akuza sipas të gjitha pikave të saj, është i vetëdijshëm për pasojat e fajësisë që mund të vijnë nga pranimi, i premtion gjykatës se nuk do të përsërit vepra të tilla, dhe e lut gjykatën të i shqiptoj një dënim më të butë.*

I dëmtuari [REDAKTUAR] lidhur me pranimin e fajësisë deklaron se: i bashkëngjitet ndjekjes penale, dhe se kërkesën pasurore juridike nuk mund ta precizoj e sillet diku rreth 200 Euro, komplet një gidor me elemente nuk më janë kthyer ndërsa në kutin të cilën me janë kthyer kanë munguar më shumë se gjysma e sendeve.

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarve, i njëjti pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPK-së po ashtu i ka propozuar Gjykatës që të akuzuarit të i shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që dy të akuzuarit kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar për të gjitha pikat në aktakuzë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 edhe përkundër paralajmërimit të te pandehurve për nenin 323 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit të parë [REDAKTUAR] dhe të akuzuarit të dytë [REDAKTUAR] gjatë shqyrtimit fillestar, si dhe deklaratat e tyre të dt. 26.09.2016 dhe dt. 02.10.2016, deklaratat e te dëmtuarit [REDAKTUAR] e dt. 28.09.2017, ,



vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt. 23.04.2013, vërtetimi mbi kthimin e sendeve te sekuestruara e dt. 02.10.2016, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;

- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave të marra në gjykim të kësaj çështje, gjykata çmon se me veprimet e tyre të kundërligjshme, të cilat kanë prekur drejtpërdrejt pasurinë e luajtshme të huaj dhe të drejtën e pronësisë së tij të mbrojtur nga legjislacioni penal, me qëllim që vetes ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm i pandehuri i parë në shtëpinë në muajin korrik të vitit 2016, rreth orës 19:00, në fshatin Rakaj komuna Ferizaj, saktësisht nga garazhi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] i pandehuri me qëllim të përvetësimit e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit të i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, ka marr një kuti me ngjyrë të zezë të mbushura me çelësa, kaçavida dhe dana pune, një kabëll vazhdues me gjatësi rreth 50 metra, një garniturë me çelësa gidore në vlerë prej 200 €, dhe i ka shitur të i pandehuri [REDAKTUAR] për shumën prej 20€ i pandehuri me qëllim të përfitimit pasuror për vete apo dikë tjetër në mënyrë të kundërligjshme kishte pranuar mallin e vjedhur nga i pandehuri [REDAKTUAR] dhe atë një kuti me ngjyrë të zezë të mbushur me çelësa, kaçavida dhe dana pune, një garniturë me çelësa gidore ku ja kishte paguar shumën në vlerë prej 20 €, për të cilën e ka ditur se të njëjtat janë përfituar me anë të kryerjes së veprës penale ku janë konfiskuar nga ana e policisë,-

Konkretisht, sa i përket objektit të veprës penale, veprimet e kundërligjshme të kryera nga të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kanë cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ruajtjen dhe paprekshmërisë e pronës dhe të drejtave pasurore të



personave fizikë e juridik nga veprimet kriminale të mbrojtura nga legjislacioni ynë penal, dhe si te tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore.

Nga ana objektive, kjo veprë është kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] me veprime aktive të kundërligjshme, duke depërtuar nga garazhi i të dëmtuarit [REDAKTUAR] i pandehuri me qëllim të përvetësimit e sendeve të huaja të luajtshme e që vetit të i sjell përfitime pasurore të kundërligjshme, ka marr një kuti me ngjyrë të zezë të mbushura me çelësa, kaçavida dhe dana pune, një kabëll vazhdues me gjatësi rreth 50 metra, një garniturë me çelësa gidore në vlerë prej 200 €, dhe i ka shitur te i pandehuri [REDAKTUAR] për shumën prej 20 Euro.

Nga ana subjektive këto veprime janë kryer nga i pandehuri [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçem për të nxjerre përfitim material, pra të pandehurit jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç'ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje nga neni 325 par. 1 dhe veprës penale blerja, pranim ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 2 të KPRK-së, meqë me datat, vendet dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi të akuzuarit me dashje direkte kanë konsumuar elementet e veprave penale të lartshënuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për dy të akuzuarit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në të gjitha fazat e procedurës penale përkatësisht që në shqyrtimin fillestar kanë pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e thelle për veprën penale të kryer, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla, nuk ka dëshmi se janë gjykuar me vendim të formës së prerë, ndërsa gjykata në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarat si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënime të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se te akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale kanë bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i



